Emri i dokumentit :001_verbal_i_asamblese_se_jashtezakonshme. Pdf
Emri origjinal i dosjes : MI.3471884.WN2008.M11914K4123.914K4123.001.PDF.P7M

Milano, me 31/10/2012
NOTER LORENZO TURCONI
Milano 20123 – Via Carducci, 26
Tel 02 86998450 – Fax 02 86998637



N. 13323 Repertori

N. 7233 Koleksioni

**VERBAL I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
REPUBLIKA E ITALISE**

Ne vitin dymije e njembdhjete, ditën e peste të muajit shtator, në orën njembdhjete e dhjete minuta 5 shtator 2011, në orën 11.10

Në Milano, në studion time në Via Carducci n. 26

Para meje Dr. Lorenzo Turconi, Noter, banues në Milano, regjistruar pranë Kolegjit Noterial të Milanos.

U paraqit personalisht Zoti:

- **GIZZI Camilo**, lindur në Cremona (CR) më 14 korrik 1959, banues në Milano (MI) në Piazza Della Republica n. 1/A

Per identitetin e të cilit unë Noteri jam i sigurte, Shtetas Italian.

Pasi i paraqituri, duke vepruar në cilësinë e Presidentit të Keshillit të Administrimit të Shoqërisë:

“emmecidue S.r.l.”

Me seli në Milano (MI) në Via Balzaretti n. 17,

me një kapital themeltar të nënshkruar e të derdhur prej 2.095.000,00 EURO (dy milion e nëntëdhjete e pesë mijë euro), Kod Fiskal dhe numer regjistrimi 13351470151 të Regjistrimit Tregetar të Milanos, regjistruar në R.E.A. të Dhomes së Tregetisë së Milanos me n. 1642610;

me kërkoj me konsensusin unanimit të asamblese, të mbaj dhe të konstatoj lidhur me të gjitha efektet ligjore për zhvillimin dhe vendimarrjen e asamblese të ortakeve të shoqërisë së sipërpermendur, të mbledhur sot, në këto orë, në këto vend, sipas lajmërimit të bere nga organi administrativ dhe të marrë nga të gjithë ata që e kanë këto të drejta, me datën 10 gusht 2011, sipas modaliteteve të parashikuara nga statuti.

Duke respektuar kërkesën unë noteri mbaj këto verbal si më poshtë:

E merr kryesimin e asamblese sipas nenit 22 të statutit të shoqërisë Z. GIZZI Camillo, i cili konstaton prezencën personalisht apo nëpërmjet përfaqësimit të kapitalit të barabartë me 1.990.250,00 EURO (një milion e nëntëqind e nëntëdhjete mijë e dyqind e pesëdhjete euro), përkundërsisht të gjithë kapitalit të shoqërisë prej 2.095.000,00 EURO (dy milion e nëntëdhjete e pesë mijë euro), të ndarë në këto mënyre:

- Kuota prej euro 1.527.460,30 (një milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjete pike tridhjetë euro) zotëruar nga Z. GIZZI Camillo, i pranishëm personalisht;
- Kuota prej euro 182.386,51 (njëqind e tetëdhjete e dy mijë e treqind e tetëdhjete e gjashtë pike pesëdhjete e një euro) zotëruar nga Z. PETRUCCI Francesco, i pranishëm personalisht;
- Kuota prej euro 1.927,40 (një mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë pike dyzet euro) në zotërim të Znj. LO GUZZO Carmella, e përfaqësuar me prokurë nga Z. GIZZI Camillo;



- Kuota prej euro 178.963,29 (njqind e shtatedhjete e tete mije e nenteqind e gjashtedhjete e tre mije pike njezet e nente euro) ne zoterim te Z. PEDRAZZINI Sergio Gabriele, i pranishem personalisht;
- Kuota prej euro 104.750,00 (njqind e katermije e shtateqind e pesedhjete euro) ne zoterim te Shoqerise "CANARBINO INVEST Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar – Unipersonale" me seli ne Sarzana Via Circonvallazione n. 2 MUNGON;

si dhe ne prani te anetareve te Keshillit te Administrimit Z. PEDRAZZINI Sergio Gabriele, TOMASONI Ricardo, PETRUCCI Francesco dhe anetareve te Grupit te Eksperteve LEONI Maurizio – President, CERIANI Graziano dhe SCALIONE Paride, dhe ne mungese te justifikuar keshilltari tjetër BAISI Giorgio Alex;

duke u konsideruar e mbledhur rregullisht asamblea eshte e gatshme per te diskutuar e vendosur lidhur me rendin e dites si me poshte

- Rritja e kapitalit te shoqerise nga 2.095.000,00 EURO (dy milion e nentehjete pese mije euro) ne 3.863.000,00 EURO (tre milion e teteqind e gjashtedhjete e tre mije euro) nepermjet perdorimit te rezerves se te ardhurave;
- Vendimi per ceshtjet e tjera;
- Te ndryshme

E merr fjalen Presidenti i asamblese i cili kujton se me Vendimin e Asamblese te dates 22 prill 2010 n. 11509/6283 te repertorit tim, eshte vendosur rritja e kapitalit nga 2.095.000,00 euro (dy milion e nentehjete pese mije euro) ne 2.304.500,00 euro (dy milion e treqind e katermije e peseqind euro), per tu nenshkruar brenda dates 31 korrik 2011 dhe se ky nenshkrim nuk eshte bere; lidhur me kete behet e ditur se kapitali i shoqerise edhe sot duhet vendosur, nenkuptuar, nenshkruar e derdhur ne shumen 2.095.000,00 euro (dymilion e nentehjete e pese mije euro).

Duke vazhduar me trajtimin e ceshtjes, Presidenti i paraqet te pranishmeve arsyet qe sipas nevojave ne rritje te shoqerise, keshillon te rrisin kapitalin e saj nga 2.095.000,00 euro (dymilion e nentehjet e pese mije euro) ne 3.863.000,00 euro (tremilion e teteqind e gjashtedhjete e tre mije euro), dhe ekspozon modalitetet per te proceduar lidhur me kete zmadhim kapitali ne forme te garantuar, duke rritur proporcionalisht pjesemarrjet ne shoqeri nepermjet perdorimit te rezerves se te ardhurave.


Ne perfundim Presidenti i Asamblese, ne cilesine e tij dhe si President i Keshillit te Administrimit, deklaroi se kapitali i shoqerise prej 2.095.000,00 euro (dymilion e nentehjet e pese mije euro) eshte teresisht i paguar dhe i nenshkruar.

Presidenti i Grupit te Eksperteve Dr. Maurizion LEONI ne emer te vete Grupit te Eksperteve, shpreh opinionin ne favor te ketij propozimi dhe deklaroi se kapitali i shoqerise prej 2.095.000,00 euro (dymilion e nentehjet e pese mije euro) rezulton teresisht i paguar e i nenshkruar.

Asambleja, pasi degjoi persa parashtrroi Presidenti i saj, dhe mori mendimin ne favor te Grupit te Eksperteve,

me unanimitet vendosi

- Te miratoje zmadhimin e kapitalit ne 2.304.500,00 euro (dymilion e treqind e katermije e peseqind euro) vendosur sipas vendimit te siperpermendur te asamblese dt. 22 prill 2010, me nr. 11509/6283 te repertorit tim, i cili nuk rezulton te jete nenshkruar sipas afateve te vendosura;

- 
- Te zmadhoje gratis kapitalin e shoqerise nga 2.095.000,00 euro (dymilion e nentedhjet e pese mije euro) ne 3.863.000,00 euro (tremilion e teteqind e gjashtedhjet e tre mije euro), dmth me 1.768.000,00 euro (nje milion e shtateqind e gjashtedhjet e tete mije euro) duke rritur proporcionalisht kuotat e poseduara ne shoqeri nepermjet perdorimit te shumave nga pjesa e "Te ardhura te riinvestuara" qe sipas aprovimit te bilancit te shoqerise me 31 dhjetor 2010 vleresohet ne shumen 1.768.235,93 euro (nje milion e shtateqind e gjashtedhjet e tete mije e dyqind e tridhjet e pese pike nentedhjet e tre euro) dhe qe reduktohet ne 235.93 euro (dyqind e tridhjet e pese pike nentedhjet e tre euro);
 - Keshtu kapitali i shoqerise rezulton nga sot ne vleren prej 3.863.000,00 euro (tremilion e teteqind e gjashtedhjet e tre mije euro), i gjithi i derdhur dhe nenshkruar e i ndare ndermjet ortakeve si me poshte:
 - Kuota prej euro 2.816.513,30 (dy milion e teteqind e gjashtembedhjet mije e peseqind e trembedhjet pike tridhjet euro) zoteruar nga Z. GIZZI Camillo;
 - Kuota prej euro 336.312,78 (treqind e tridhjet e gjashte mije e treqind e dymbedhjet pike shtatedhjet e tete euro) zoteruar nga Z. PETRUCCI Francesco;
 - Kuota prej euro 183.492,50 (njeqind e tetedhjet e tre mije e katerqind e nentedhjet e dy pike pesedhjet euro) zoteruar nga Z. TRUCCI Francesco;
 - Kuota prej 3.553,96 euro (tremije e peseqind e pesedhjet e tre pike nentedhjet e gjashte euro) ne zoterim te Znj. LO GUZZO Carmella;
 - Kuota prej euro 329.977,46 (treqind e njetzet e nente mije e nenteqind e shtatedhjet e shtate pike dyzet e gjashte euro) ne zoterim te Z. PEDRAZZINI Sergio Gabriele;
 - Kuota prej euro 193.150,00 (njeqind e nentedhjet e tre mije e njeqind e pesedhjet euro) ne zoterim te Shoqerise "CANARBINO INVEST Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar – Unipersonale" ;
 - Per rrjedhoje, te modifikojne paragrafin e pare te nenit 5 te statutit te shoqerise qe do te jete si me poshte:

5) kapitali i shoqerise eshte 3.863.000,00 euro (tremilion e teteqind e gjashtedhjet e tre mije euro).

E pandryshuar si me poshte:
 - Te autorizoje Z. GIZZI Camillo me te gjitha te drejtat me te gjera te perfshije ne vendimet si me siper te gjitha ndryshimet, shtesat e nderprerjet qe mund te kerkohen nga autoritetet gjyqesore kompetente lidhur me keto miratime.

Pas kesaj, pasi nuk kishte gje tjeter per te vendosur dhe askush nuk e kerkoi fjalen, Asamblea u mbyll ne oren njembedhjet e dyzet minuta.

Vertetohet bazuar ne nenin 2436 te Kodit Civil se, sipas modifikimeve te vendosura si me siper, statuti i azhornuar i shoqerise eshte ky qe i nenshkruar, i bashkangjitet ketij akti ne formen e Shtojces "A".

Sipas kerkeses, une noteri redaktova kete akt qe ua bera te ditur te pranishmeve duke e lexuar, te cilet e pranojne e konfirmojne dhe nenshkruajne bashke me mua Noterin, duke lexuar dhe sa parashtrohet ne shtojcen "A", duke shprehur vullnetin e te paraqiturve.

Ky akt perbehet nga dy faqe te shkruara ne shtate flete deri ketu ne te teten, me makine personalisht dhe nje pjese e shkruar me dore dhe e nenshkruar prej meje noterit ne oren njembdhjete e dyzet minuta.

Nenshkruar Camillo Gizzi
Nenshkruar Lorenzo Turconi noter
Bashkangjitur "A" me nr. 13323 repertori
n. 7233 koleksioni

**STATUTI
QE PERMBAN NORMAT E FUNKSIONIMIT TE SHOQERISE**

EMRI – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

- 1) Eshte themeluar shoqeria per pergjegjesi te kufizuar me emrin:
"emmecidue s.r.l."
- 2) Shoqeria e ka seline ne **Milano (MI)**.
Transferimi i selise se shoqerise ne territorin e te njejtës Komune vendoset nga Asambleja e ortakeve.
Njoftimi i ketij transferimi rregullhet sipas nenit 111 dhe dispozitat aktuale te Kodit Civil.
Shoqeria mund te themeloje e te formoje dhe jashte shtetit, seli apo filiale, agjensi apo zyra perfaqesimi.
Vendbanimi i ortakeve, i administratoreve, te ekonomistëve apo revizoreve, nese ka te emeruar, per sa i takon raporteve te tyre me shoqerine, eshte ai qe rezulton nga librat e shoqerise.
Per kete qellim shoqeria mund te kete librin e saj, me detyrimin e organit administrativ qe te mbaje azhornimin e tij.
- 3) Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:
 - realizimin dhe zhvillimin e impianteve te prodhimit te energjise se rinovueshme pa u kufizuar ne impiante te biomases, eolitike, fotovoltaike, projektimin dhe ndertimin e impianteve hidroelektrike, me shfrytëzim te energjise termike edhe permes prjektimit dhe realizimit te rrjeteve;
 - shoqeria gjithashtu mund te menaxhoje cdo lloj impianti te prodhimit te energjise;
 - ushtrimin e cdo lloj veprimtarie tjeter industriale apo tregtare ne perputhje me legjislacionin aktual ne fuqi;
 - prezantimin e sherbimeve dhe ne vecanti te veprimtarise se konsulences ne fushen energjitike ne favor te personave fizike dhe juridike te se drejtes publike dhe private italiane dhe te huaj;
 - prezantimin e sherbimeve post contatore, te llojit teknologjik, me prespektive optimizimin dhe racionalizimin e konsumit te energjise;
 - ndertimin dhe instalimin e impianteve elektrike, elektronike dhe atyre me gaz, si dhe sherbimet perkates te asistences dhe mirembajtes;



- realizimin e studimit te tregut, planeve te ristrukturimit dhe te futjes se shoqerise ne treg, analiza sektoriale dhe teresore te shoqerive;
- kerkimin dhe gjetjen e personelit, ne cdo lloj forme dhe modaliteti, ne perputhje te plote legjislacionin perkates per rregullimin e marredheneieve te punes si dhe ne perputhje me legjislacionin ne fushen e se drejtes se punes;
- kerkimin, projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shperndarjen e produkteve dhe sherbimeve editoriale informuese dhe telematike;
- shitblerjen e patentave ne fushen e burimeve te energjise;
- ndertimin dhe riparimin e pajisjeve elektronike dhe te trasmetimit dhe marrjes se te dhenave;
- ndertimin, menaxhimin, tregtimin dhe shperndarjen ne itali dhe jashte saj, ne rruge direkte dhe/ose indirekte, per llogari te saj dhe/ose te te treteve te produkteve dhe programeve software, faqeve world wide (web) dhe site te tjera virtuale (internet), perfshire tekstet, imazhet, tingujt, dhe informacionet;
- menaxhimin e rrjeteve telematike dhe sherbime ne rrjete qofshin kombetare dhe nderkombetare per llogari te saj apo te te treteve duke kontraktuar per kete qellim agjensi apo zyra perfaqesimi te degeve te tjera te sektorit editorial, informativ, dhe telekomunikativ;
- mbledhjen e informacioneve dhe e te dhenave per ndertimin dhe dhenien me qira te botimeve telematike dhe elektronike;
- zhvillimin e aktivitetit botues dhe ne pergjithesi mnaxhimin e mjeteve te administrimit (me perjashtimet te mjeteve te komunikimit te perditshem te asimiluar prej tyre); publicitare, informative, telematike, dhe multimediale;
- shperndarjen e produkteve dhe sherbimeve editoriale te permendura me siper, ne cdo lloj forme dhe menyre, gjysme instrmentale, per realizimin e aktivitetit te permendur me siper, te prodhimit, shitjes, menaxhimit dhe shperndarjes se produkteve te botimeve elektronike dhe telematike;
- perpunimin e programeve software per perpunimin e te dhenave te shoqerise perfshire asistence ne aplikimin e tyre, komercializimin e procedurave dhe i programeve te siperpermendura;
- pergatitjen dhe realizimin e kurseve te formimit, si dhe organizimin e mbledhjeve dhe konferencave te ndryshme, qe lidhen me objektin e shoqerise, per llogari te saj apo te personave te trete;
- veprimtarite dhe aktivitetet e siperpermendura mund te realizohen me anen e mjeteve te ndryshme te telekomunikacionit te ofruara nga tregu si dhe te atyre ende te padisponueshme ne perudhen e hartimit te ketij statuti, i cili eshte me titull te kufizuar por jo i limituar per: internet, komunikime satelitore, permes kablove, etj;
- per realizimin e objektit te shoqerise, shoqeria mund te kryeje marre pjese ne bashkime dhe koncensione te perkohshme me ente te tjera publike dhe ose private, te nenshkruaje me kete ente marreveshjet perkatese per hyrjen ne bashkepunim me to;
- blerjen dhe shitjen per llogari te saj dhe jo te te treteve te, te pasurive te luajtshme, qofshin keto kuota ose jo, vendase apo te huaja, shitblerjen per llogari te saj dhe jo te te treteve te kontratave qe derivojne nga titujt italiane ose te huaj, ne tregun italian dhe ate te huaj, per gjithcka, me



perjashtim te shprehur te mbledhjes se te ardhurave te publikut dhe te aktiviteve te rezervuara per shoqerite financiare dhe per bankat, tek s.i.m, s.g.r., dhe sicav.

ne lidhje me objektin dhe me karakter teresisht funksional dhe jo ne rruge prevalente dhe jo ne kufinjte e bashkepunimit dhe ne perputhje me kufizimet e parashikuara nga ligji nr. 197/91 dhe nr. 58/98:

A) mund te ushtroje cdo veprimtari tjeter imobilare, mobilare, financiare, dhe tregtare qe konsiderohen te nevojshme per permbushjen e objektit te shoqerise, perfshire ketu leshimin e garancive reale dhe personale ne favor te personave te trete,

B) mund te marre pjese ne shoqeri, entitete dhe organizime (te cilat jane krijuar ose jane ne krijim) te cilat kane objekt te njejte ose te ngjashem me te sajin.

gjithashtu mund te kryeje aktivitetin e mbledhjes se te ardhurave mbi bazen e financimeve, qofshin me titull te dhuruar, te bere nga ana e ortakeve te regjistruar te pakten tre muaj perpara ne librin e ortakeve, dhe qe zoterojne te pakten 2% te kapitalit te shoqerise qe rezulotn nga bilanci i fundit i miratuar; sic eshte e parashikuar ne vendimin e dates 3 mars 1994 te c.i.c.r ne perditesim te dekretit legjislativ 1/09/1993 nr. 385, (permbledhje e ligjeve me fushen bankare dhe kredituese) dhe e cdo ligji tjeter qe do te regulloje ne te ardhmen kete fushe.

4) Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte percaktuar sipas aktit te themelimit, deri me 31 dhjetor 2050.

KAPITALI I SHOQERISE – DEPOZITIMET

5) Kapitali i shoqerise eshte 3.863.000,00 euro (tremilion e teteqind e gjashtedhjetë e tre mije euro).

Pjesemarrjet e ortakeve mund te jene dhe ne pjese joproporcionale me derdhjet, qofte sipas themelimit dhe sipas modifikimit te kapitalit te shoqerise.

Kapitali mund te zmadhohet nje ose disa here me vendim te asamblese te marre me maxhorancen e parashikuar per ndryshimet e aktit te themelimit.

Pavec sa parashikohet ne nenin 2482 te Kodit Civil, zmadhimi i kapitalit mund te behet dhe nepermjet ofertes se pjesemarrjes nepermjet emetimit ne favor te te treteve; ne kete rast u takon ortakeve qe nuk i jane pergjigjur vendimit me te drejten e heqjes dore sipas nenit 2473 te Kodit Civil.

6) Ne rastet e zvogelimit te kapitalit te shoqerise ne me teper se nje te tretet si pasoje e humbjeve, mund te vihet depozite ne seline e dokumentave te shoqerise sipas parashikimeve te nenit 2482, paragrafi i dyte i Kodit Civil, sipas parashikimeve te asamblese te percaktuara ketu.

7) Shoqeria mund te bleje nga ortakët derdhje dhe financime, me titull te mbajtur dhe te garantuar, me ose pa te drejten e rimbursimit, duke respektuar normativat ne fuqi, me rregullimin e vecante te atyre qe rregullojne mbledhjen e kursimeve nga publiku.

Rimbursimi i financimeve te ortakeve ne favor te shoqerise, eshte objekt i kufizimeve sipas nenit 2467 te Kodit Civil.

8) Qofte ne seline e themelimit te shoqerise, qofte ne seline e zmadhimit te kapitalit, mund te derdhen te gjitha elementet e aktiveve te shoqerise te vleresimeve ekonomike dhe vecanerisht ne para, kontribut ne natyre, kreditime, sherbime te tjera ne favor te shoqerise.

Ne rastin e kontributit qe kane per objekt pune e sherbime ne favor te shoqerise poliza e sigurimit apo garancia bankare qe garantojne keto sherbime, mund te jene ne cdo moment te zevendesueshme nga ortaku, nepermjet depozitimit ne shoqeri te shumes korresponduese ne para.

9) Ne rastet e parashikuara nga neni 2466 I Kodit Civil, eshte lejuar shitja e pjeses se ortakut te percaktuar.

TRANSFERIMI I PJESEMARRJEVE

10) Kuotat e shoqerise jane lirisht te transferueshme tek te tretet me akt midis te gjalleve, pas ushtrimit te te drejtes se parablerjes ne barazi te kushteve, qe u rezervohet ortakeve ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secilli prej tyre, e drejte e cila duhet te ushtrohet brenda tridhjete diteve nga komunikimi i kerkeses per ta ushtruar kete te drejte, nepermjet postes rekomande, nga ana e ortakut qe kerkon te shese kuotat.

Kalimi i pronesise tek nje shoqeris fiduciare apo rikalimi tek zoteruesit efektive, apo tek te afermit e tyre ne linje te drejte apo tek bashkeshorti, tek trashegimtarete apo te pasardhurit pas vdekjes, nuk eshte objekt i sa parashikohet ne kete nen, me kushtin qe shoqeria fiduciare adopton deklaraten e transferimit

E drejta e parablerjes sic percaktohet me lart, nuk aplikohet ne rastin e transferimit te kuotave ndermjet ortakeve.

11) Kuotat jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

HEQJA DORE

12) Kane te drejte te heqin dore ortaket qe nuk kane marre pjese ne aprovimin e vendimeve te poshteshenuara:

- Ndryshimi i objektit apo tipit te shoqerise; bashkimi apo shperberja; revokimi i gjendjes se likuidimit; transferimi i selise se shoqerise jashte vendit; eliminimi i nje apo me shume rasteve te heqjes dore te parashikuara nga akti i themelimit apo statuti;
- Permbushja e operacioneve qe perbejne nje modifikim substancial te objektit te shoqerise te percaktuar ne aktin e themelimit apo ndonje modifikim i mundshem i atributeve te ortakeve sipas normave te nenit 2468, paragrafi kater i Kodit Civil;
- Rritja e kapitalit te bere nepermjet ofertes emetimit te kuotave te reja ne favor te te treteve; Heqja dore eshte e drejte e ortakeve, nese shoqeria eshte objekt i nje aktiviteti te administruar apo te kontrolluar, sipas hipotesave te parashikuara ne nenin 2497 te kodit civil. Ortaket kane te drejten e largimit nga shoqeria ne zbatim te dispozitave te nenit 2469 paragrafi i dyte i Kodit Civil.
Heqja dore duhet te ushtrohet nepermjet nje komunikimi te shkruar derguar shoqerise me poste rekomande brenda tridhjete diteve ne vazhdim, sipas
- Nga regjistrimi ne regjistrin Tregetar te vendimit te asamblese se ortakeve qe e legjitimon; ku eshte e parashikuar;
- Ne mungese, nga transkriptimi i vendimit ne librin e vendimeve te ortakeve;



- Nga marrja dijoni nga ana e ortakut qe heq dore te faktit qe i legjitimon heqjen dore. Komunikimi i largimit duhet njoftuar nen kujdesin e organit administrativ, ne librin e ortakeve.

Heqja dore ka efekt duke filluar tridhete dite nga dita kur deklarata e heqjes dore ka mberritur ne seline e shoqerise. Nuk mund te ushtrohet, dhe nese eshte ushtruar nuk eshte e vlefshme, nese brenda nentredhete diteve nga ushtrimi i doreheqjes, shoqeria revokon vendimin qe e legjitimon ose nese eshte vendosur likuidimi i shoqerise.

Ortaket qe largohen nga shoqeria kane te drejten e rimbursimit te kuotes se tyre ne perpjesetim me pasurine e shoqerise, sipas modaliteteve te parashikuara nga neni 2473, paragrafi i trete e i katert i Kodit Civil.

Heqja dore nuk mund te ushtrohet vetem per nje pjese te kuotes se zoteruar.

Ne rastet kur rimbursimi i kuotes nuk eshte i mundur dhe qofte nepermjet blerjes se saj nga ana e ortakeve te tjere, rimbursimi mund te behet duke perdorur rezervat e disponueshme ose ne mungese dhe te kesaj, duke reduktuar kapitalin e shoqerise, sipas parashikimeve te nenit 2482 te Kodit Civil. Nese, dhe sipas ketyre normave, nuk eshte e mundur rimbursimi i kuotes se ortakut te larguar, shoqeria do te shkoje ne likuidim.

E drejta e heqjes dore nuk mund te ushtrohet dy vitet e para te themelimit te shoqerise apo te nenshkrimt te kuotave te pjesemarrjes.

PERJASHTIMI

- 13) Nuk jane parashikuar raste te perjashtimit te ortakut per nje arsye te drejte.

ADMINISTRIMI I VEPRIMTARISE, DREJTIMI E KONTROLLI

- 14) Shoqeria duhet te beje te ditur administrimin e saj dhe aktivitetin e drejtimit dhe te koordinimit ne aktet dhe korrespondencen e saj, si dhe nepermjet regjistrimit, nen kujdesin e administratoreve, ne seksionin e regjistrin tregetar, sipas nenit 2497, paragrafi i dyte i Kodit Civil.

VENDIMET E ASAMBLESE DHE ORTAKEVE

- 15) Ortaket vendosin lidhur me ceshtjet ne kompetence te tyre, sipas ligjit apo sipas ketyre normave te funksionimit te shoqerise, dhe sipas ceshtjeve qe kerkojne miratimin e tyre, te nje apo disa administratoreve apo te nje numri ortakesh qe perfaqesojne te pakten nje te terten e kapitalit te shoqerise.
- 16) Jane ne kompetence te ortakeve;
 - 1) Aprovimi i bilancit dhe shperndarja e te ardhurave;
 - 2) Emerimi dhe revokimi i administratoreve dhe struktura e organit administrativ;
 - 3) Emerimi dhe revokimi i eksperteve dhe i presidentit te grupit te eksperteve apo te revizoreve;
 - 4) Modifikimet e aktit te themelimit;
 - 5) Vendimet lidhur me permbushjen e operacioneve qe perbejne nje modifikim thelbesor te objektit shoqeror apo nje modifikim te te drejtave te ortakeve;
 - 6) Emerimin dhe revokimin e likuidatoreve dhe te kritereve te kryerjes se likuidimit;
 - 7) Transferimi i selise se shoqerise ne te njejtin komune;
 - 8) Vendimi lidhur me largimin e ortakut, kur eshte kompletuar procedura;




- 17) Cdo ortak i regjistruar ne librin e ortakeve ka te drejten te marre pjese ne vendimet dhe vota e tij ka vlere ne proporcion me pjesen e tij te zoteruara ne kapitalin e shoqerise; ortaku jo kompetent (apo ortaku te cilit garanzia bankare apo polica siguruese i ka perfunduar apo i eshte bere e pavlefshme sipas parashikimeve te nenit 2466 paragrafi i peste i Kodit Civil) nuk mund te marre pjese ne vendimarrjen e ortakeve.
- 18) Ne rastet e vendimeve qe kane per objekt modifikimet e aktit te themelimit apo permbushjen e operacioneve qe konsistojne ne nje ndryshim thelbesor te objektit te shoqerise apo modifikim te te drejtave te ortakeve dhe kur e kerkojne nje ose disa administratore apo ortaket qe perfaqesojne te pakten nje te treten te kapitalit te shoqerise, apo kur parashikohet shprehimisht nga ligji, vendimet e ortakeve duhet te merren ne fome asembleje.
- 19) Asambleja e ortakeve thirret nga Organi Administrativ qofte dhe jashte selise zyrtare te shoqerise, por ne territorin kombetar apo ne territorin e nje vendi tjetër anetar te Bashkimit Europian; ne rastet e pamundesise te te gjithë administratoreve, apo inaktivitetit te tyre, asambleja mund te mbledhet nga grupi i eksperteve apo nga revizoret, nese ka te emeruar, apo qofte dhe nga nje ortak. Asambleja per aprovimin e bilancit mund te mbledhet te pakten nje here ne vit, brenda njeqind e njetzet diteve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Aprovimi i bilancit mund te behet brenda njeqind e tetedhjetë diteve nga mbyllja e vitit ushtrimor, ne rastet e ekzigjencave te vecanta apo kushteve te parashikuara ne ligj.
- 20) Asambleja thirret nepermjet njoftimit te shperndare me leter rekomande, telefax apo mesazh te postes elektronike (ne rastet kur rezulton ne librin e ortakeve numri i faksit apo adresa e postes elektronike te te gjithë atyre qe kane te drejte te marrin pjese ne asamble), duke u cuar te pakten tete dite me pare, ose te marre te pakten pese dite parpara dates se asamblese, tek te gjithë ata qe kane te drejte te marrin pjese ne asamble, ne adresen e banimit qe rezulton nga librat e shoqerise, dhe do te jete e vlefshme edhe ne rast te mos respektimit te formes se thirrjes se asamblese, nese ne te merr pjese i gjithë kapitali i perfaqesuar i shoqerise si dhe te gjithë administratoret dhe ekspertet e emeruar, dhe bien dakort per trajtimin e pikave te rendit te dites. Nese administratoret apo ekspertet e emeruar, nuk marrin pjese personalisht ne asamble, duhet te leshojne nje deklarate te shkruar, e cila ruhet ne aktet e shoqerise, ne te cilen deklarojne se jane informuar per mbledhjen dhe nuk kane kundërshtime lidhur me trajtimin e pikave te rendit te dites. Asambleja do te jete e mbledhur ne menyre te vlefshme dhe e zonja per te marre vendime dhe ne rastet e prezences se pjesemarrësve nepermjet mjeteve telematike apo videotelefonike, duke garantuar kushtet e meposhtme:
 - a) Qe me lajmerimin e thirrjes te jene percaktuar vendet audio/video te lidhura, ne te cilat te ftuarit mund te komunikojne;
 - b) Qe ne vendin e mbledhjes te jene te pranishem fizikisht Presidenti dhe Sekretari i ngarkuar me redaktimin e procesverbalit;

- c) Qe subjektet qe kane te drejte te marrin pjese ne asamble e qe nuk jane te pranishem fizikisht te mund te identifikohen nga Presidenti dhe Sekretari;
- d) Qe subjektet jo te pranishem fizikisht te mund qe ne kohe reale te ndjekin diskutimet, te njihen me dokumentat e paraqitura, te nderhyjne ne trajtimin e pikave te rendit te dites, te paraqesin dokumenta dhe te bisedojne ndermjet tyre dhe ku jane fizikisht te pranishem Presidenti dhe Sekretari.
- Sekretari do te hartoje procesverbalin e asamblese duke e shkruar ne librin perkates i cili nenshkruhet nga Presidenti dhe sekretari.
- 21) Cdo ortak qe ka te drejte te marre pjese ne asamble mund te perfaqesohet me autorizim te shkruar nga nje person tjetër apo nga nje ortak, i cili ruhet ne shoqeri.
- 22) Asambleja kryesohet nga Administratori i Vetem apo nga presidenti i Keshillit te Administrimit apo nga nje nga administratoret, dhe ne mungese te tyre nga nje person i caktuar nga te pranishmit. Asambleja emerone nje sekretar, qofte dhe jo ortak, dhe nese e konsideron te nevojshme zgjedh dhe dy anetere. Eshte e drejte e Presidentit te konstatoje nese asambleja eshte rregullisht e mbledhur, te sigurohet per identitetin dhe legjitimitetin e te pranishmeve, te drejtoje e te rregulloje zhvillimin e asamblese dhe te sigurohet e te beje te ditur rezultatet e votimit;
- 23) Vendimet e asamblese mbahen ne proces verbal, te nenshkruar nga Presidenti ose nga Sekretari si dhe nga anetaret.
- Ne rastet e parashikuara nga ligji dhe kur Presidenti i asamblese e sheh te nevojshme, verbali redaktohet nga Noteri i zgjedhur nga asambleja.
- 24) Pervec rasteve kur vendimet e ortakeve duhet te merren ne forme asambleare, ne rastet e parashikuara nga kodi civil dhe nga statuti, vendimet e ortakeve mund te merren nepermjet konsultimit me shkrim ose nepermjet konsensusit te shprehur me shkrim.
- 25) Procedura e konsultimit me shkrim apo te marrjes se konsensusit te shprehur me shkrim nuk eshte subjekt i procedurave te vecanta, por duhet ti sigurohet cdo ortaku e drejta e marrjes pjese ne vendim si dhe ti sigurohet informacioni i nevojshem.
- Vendimi merret nepermjet aprovimit me shkrim te nje dokumenti te vetem, apo i disa dokumentave qe permbajne te njejtin tekst vendimi, nga ana e te gjithe ortakeve qe perfaqesojne mazhorancen e kapitalit te shoqerise.
- 26) Asambleja eshte rregullisht e mbledhur me prezencen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten gjysmen e kapitalit te shoqerise dhe vendos me mazhorancen absolute.
- Ne rastet e parashikuara ne nenin 16 numrat 4) 5) dhe 6) eshte e nevojshme vota ne favor e ortakeve qe perfaqesojne te pakten mazhorancen e kapitalit te shoqerise.
- 27) Ne rastet e vendimeve te ortakeve te marre nepermjet konsultimit te shkruar apo ne baze te nje konsensusi i shprehur me shkrim, vendimet merren me voten ne favor te ortakeve qe perfaqesojne mazhorancen e kapitalit te shoqerise.


ADMINISTRIMI


- 28) Shoqeria mund te administrohet, sipa vendimit te ortake, ne seline e shoqerise:
- a) Nga nje administrator i vetem;

- 
- b) Nga Keshilli i Administrimit i perbere nga dy deri ne shtate anetare, sipas numrit te vendosur nga ortaket ne momentin e emerimit;
 - c) Nga dy ose me shume administratore me tagra te bashkuara, te ndara apo te ushtruara me shumicen.

Ne rast te emerimin te dy apo me shume administratore pa treguar lidhur me modalitetet e ushtrimit te tagrave te administrimit, nenkuptohet formimi i nje keshilli administrimi. Administratoret mund dhe te mos jene ortake dhe qendrojne ne detyre me kohe te pacaktuar deri ne revokim apo doreheqje, pervec rasteve te vendosura ndryshe ne aktin e emerimit dhe jane te rizgjedhshem.

- 29) Ne rastet kur administrimi i besohet nje Keshilli Administrimi, dhe nese nga doreheqja apo arsye te tjera mungon mazhoranca e administratoreve ne detyre, ose ne rastet kur, gjithnje per doreheqje apo per arsye te tjera mungon Presidenti i Keshillit te Administrimit, nenkuptohet i rene i gjithe Keshilli dhe keshilltaret e tjere duhet qe me urgjence te mbledhin ortaket per te vendosur lidhur me emerimin e organit te ri administrativ. Kur administrimi i besohet Keshillit te Administrimit i perbere nga dy anetare, ne rastet e mosperputhjes lidhur me revokimin e keshilltarit te deleguar, konsiderohet i rene i gjithe keshilli dhe duhet proceduar me emerimin e organit te ri administrativ.
- 30) Kur administrimi i besohet Keshillit te Administrimit, ky, kur nuk percaktohet nga asambleja, zgjedh midis anetareve te tij nje President si dhe nje Zevendes President.
- 31) Keshilli mblidhet dhe ne vende te tjera te ndryshme nga selia e shoqerise, por ne Itali ose ne territorin e nje vendi tjetër anetar te Bashkimit Europian, ne te gjitha rastet qe Presidenti e gjykon te nevojshem ose kur eshte bere kerkese me shkrim nga mazhoranca e keshilltareve. Thirrja behet nga Presidenti apo nga Administratori i Deleguar, nepermjet lajmerimit te bere te gjithe administratoreve efektive apo revizoreve, nese ka te emeruar, me cdo mjet te pershtatshem per te siguruar proven e marrjes te pakten pese dite para mbledhjes ose ne rast urgjence te pakten dy dite me pare. Keshilli mundet te vendose sidoqofte ne menyre te vlefshme dhe ne mungese te nje thirrjeje formale kur jane prezente te gjithe anetaret e tij dhe nese ka te emeruar, te gjithe revizoret apo ekspertet. Keshilli vendos ne menyre te vlefshme dhe me prezencen e shumices se administratoreve duke marre vendim nepermjet mjeteve telematike apo videotelefonike, duke u plotesuar kushtet e meposhtme:
 - a) Qe ne vendin e mbledhjes te jene te pranishem fizikisht Presidenti dhe Sekretari i ngarkuar me redaktimin e procesverbalit;
 - b) Qe keshilltaret qe nuk jane te pranishem fizikisht te mund te identifikohen nga Presidenti dhe Sekretari;
 - c) Qe keshilltaret jo te pranishem fizikisht te mund qe ne kohe reale te ndjekin diskutimet, te njihen me dokumentat e paraqitura, te nderhyjne ne trajtimin e pikave te rendit te dites, te paraqesin dokumenta dhe te bisedojne ndermjet tyre dhe ku jane fizikisht te pranishem Presidenti dhe Sekretari. Sekretari do te hartoje procesverbalin e Keshillit duke e shkruar ne librin perkates i cili nenshkruhet nga Presidenti dhe sekretari.

- 
- 32) Vendimet e keshillit jane te vlefshme nese eshte prezente shumica e anetareve te saj dhe vendoset me mazhorance absolute te votave te te pranishmeve.
- 33) Vendimet e keshillit te administrimit mund te merren dhe nepermjet konsultimit te shkruar ose nepermjet konsensusit te shprehur ne menyre te shkruar. Procedura e konsultimit me shkrim apo e marrjes se konsensusit te shprehur me shkrim nuk eshte subjekt i kufizimeve te vecanta, nese i garantohet secilit administrator, ekspert apo kontabel nese jane emeruar, e drejta e pjesemarrjes ne vendim dhe u eshte siguruar informacioni i nevojshem. Vendimi i marre nepermjet aprovimit nepermjet nenshkrimit te nje dokumenti, ose i disa dokumentave qe permbajne te njejtin tekst vendimi. Kjo procedure duhet te mbyllet 15 dite nga nisja e saj pervec ndonje afati tjeter te percaktuar ne tekstin e vendimit. Vendimet e administratoreve sipas ketij neni, duhet te trasnkriptohen ne librin e vendimeve te administratoreve. Vendimet e keshillit te administrimit te marra sipas ketij neni jane te vlefshem me voten ne favor te shumices se administratoreve ne detyre.
- 34) Administratoreve u njihet rimbursimi per shpenzimet e bera per arsye zyrtare. Me vendim te ortakeve mund tu njihet administratoreve nje shperblim vjetor i percaktuar ne proporcion me te ardhurat e rezultuara nga viti ushtrimor.
Gjithnje me vendim te ortakeve mund te njihet ne favor te administratoreve nje shperblim ne fund te mandatit, ne ngarkim te shoqerise, duke u marre nga nje shume e mbledhur ne seline e shoqerise. Kjo shume mund te jete e formuar dhe ne nje shoqeri sigurimesh.
- 35) Administratori i Vetem i ka te gjitha fuqite per administrimin e zakonshem te shoqerise, ndersa per te gjitha aktet e administrimit te jashtezakonshem duhet miratimi i ortakeve, i marre me shumicen e parashikuar ne nenin 26 paragrafi i dyte te ketij statuti.
Ne rastet kur administrimi i besohet nje Keshilli Administrimi, keshilli ka te gjitha fuqite me te gjera per administrimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise, duke ndermarre te gjitha aktet qe i konsideron te nevojshem per te arritur qellimin e objektit te veprimtarise se shoqerise.
Ne rastet e emerimin te disa administratoreve, ne momentin e emerimit te drejttat e administratoreve mund tu jepen ne menyre te bashkuar, te ndare apo sipas shumices, ose disa tagra mund ti kene te bashkuara dhe disa te tjera te ndara.
Ne mungese te nje saktesimi te tille ne aktin e emerimit, duke ndjekur modalitetet e ushtimit te detyrave te administrimit, keto te drejta nenkuptohen te dhena administratoreve te ndara midis tyre.
- 36) Keshilli mund te delegoje pjese te kompetencave te tij dhe te Presidentit, pershi te drejten e perdorimit te firmes se shoqerise, nje ose disa anetareve, duke percaktuar dhe kompetencat dhe rastet e tjera, dhe mund te emeroje Drejtore dhe perfaqesues per akte te vecanta apo per kategori aktesh.
- PERFAQESIMI**
- 37) Administratori i vetem ben perfaqesimin e shoqerise. Ne rast te emerimit te keshillit te administrimit, perfaqesimi i shoqerise behet nga Presidenti dhe nga administratoret e deleguar, nese ka te tille.



Ne rastet e emerimit te me shume administratoreve, perfaqesimi i shoqerise behet nga ata ne menyre te ndare apo te bashkuar, ne te njejtën menyre ne te cilen i jepen tagrat e administrimit.

Perfaqesimi i shoqerise behet dhe nga drejtoret dhe perfaqesuesit, sipas kufizimeve te vendosura ne aktin e emerimit.

Perfaqesimi i shoqerise ne likuidim, behet nga likuidatori apo nga Presidenti i kolegjit te likuidatoreve dhe ne raste te caktuara nga anetare te tjere te Kolegjit te Likuidimit sipas modaliteteve te percaktuara ne vendimin e emerimit.

KOLEGJI I EKSPERTEVE – REVIZORI

38) Shoqeria mund te emeruje Kolegjin e Eksperteve ose Revizorin.

Ne rastet e parashikuara ne paragrafin e dyte dhe te trete te nenit 2477 te Kodit Civil emerimi i Kolegjit te Eksperteve eshte i detyrueshem.

39) Kolegji i Eksperteve perbehet nga tre anetare efektive dhe dy suplementare, te emeruar e qe veprojne sipas ligjit.

Ekspertet emerohen per tre vite ushtrimore me afat deri ne miratimin e bilancit te vitit te trete ushtrimor ne detyre, dhe me vendim te ortakeve vendoset ne aktin e emerimi, shperblimi per kete periudhe dhe percaktohet dhe Presidenti i Kolegjit te Eksperteve si dhe te tjera sipas kerkesave ligjore.

Largimi i eksperteve per perfundim te afatit te emerimit, hyn ne efekt ne momentin e formimit te kolegjit te ri te eksperteve.

40) Si alternative e Kolegjit te Eksperteve dhe pervec rasteve te kerkesave ligjore, shoqeria emerom per kontrollin ligjor te llogarive, nje Revizor i regjistruar ne regjistrin e parashikuar nga ligji.

Per revizorin aplikohen parashikimet ligjore te percaktuar per rastet e shoqerive aksionare.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

41) Viti ushtrimor mbyllet me 31 (tridhjetë e nje) dhjetor te cdo viti, dhe ne fund te cdo viti ushtrimor Organi Administrativ ben pergatitjen e bilancit sipas ligjit.

42) Te ardhurat neto, pas heqjes se te paktes 5% (pese perqind) te rezerves ligjore perderisa kjo nuk ka arritur nje te pesten e kapitalit te shoqerise, u takon ortakeve ne proporcion me kuotat e zoteruara ne shoqeri, pervec rasteve kur ortaket kane parashikuar lidhur me rezerva te jashtezakonshme apo per destinacion tjetër, ose vendosin per ti cuar, teresisht ose pjeserisht, ne vitet e tjera ushtrimore.

TITUJT E DEBISE

43) Shoqeria mund te emetoje tituj debie, ne konformitet me sa parashikohet ne ligj, sipas vendimit te ortakeve te marre me shumicen e parashikuar per modifikimin e aktit te themelimit.

SHPERBERJA

44) Lidhur me shperberjen e shoqeria, asambleja mund te vendose ne cdo kohe, duke percaktuar modalitetet e shperberjes e likuidimit si dhe emerimin e nje apo me shume likuidatoreve, duke i percaktuar dhe detyrat.

KLAUZOLA KOMPROMISI



45) Cdo marreveshje qe mund te lindre midis ortakeve ose midis ortakeve dhe shoqerise qe ka per objekt te drejta lidhur me raportet shoqerore, dhe ne rastet kur ligji parashikon nderhyrjen e domosdoshme te Ministrise Publike, duhet te zgjidhen me nje arbiter te emeruar nga Presidenti i Urdhrit te Doktoleve Kontabel ne vendin ku shoqeria ka seline e saj, i cili duhet ta emeruje brenda dyzet diteve nga kerkesa e bere nga pala e interesuar. Ne rast se emerimin nuk behet ne afatin e siperpermendur, emerimi i kerkohet nga pala e interesuar, Presidentit te Gjykates se vendit ku shoqeria ka seline e saj. Vendi i arbitrimit behet ne vendbanimin e arbitrit.

TE TJERA

46) Per sa nuk parashikohet ne kete statut, i behet reference Kodit Civil dhe dispozitave te tij si dhe ligjeve te tjera ne fuqi.
Milano, 5 shtator 2011
Nenshkruar Camillo Gizzi
Nenshkruar Lorenzo Turconi noter

Une i nenshkruari Dr. Lorenzo Turconi Noter ne Milano, vertetoj se kjo kopjo sipas nenit 23 te D.Lgs 7.3.2005 N. 82 eshte e njejte me origjinalin e saj nenshkruar sipas ligjit dhe depozituar ne Regjistrin Tregetar.
Vene taksa e pulles sipas kerkesave te Dekretit 22.2.2007 sipas Modelit te Vetem Informativ.
Milano me 14 shator 2011

**Regjistri Tregetar
Arkivi kombetar I dokumentave**



**Dhoma e Tregetise e Industrise Artizanatit dhe Agrikultures
se MILANOS**

Sipas nenit 24 DPR 581/95 leshohet kopjo e dokumentit, te protokolluar te Regjistrin Tregetar te Shoqerive MI/RI/PRA/2011/000257218 ne daten 14/09/2011 dhe vertetohet vertetesia e regjistrimeve te bera ne arkivin informativ te Regjistrin Tregetar.

Numri i faqeve: 16

Pergjegjesi
(nenshkruar)

Milano me 31/10/2012



APOSTILE

(KONVENTA E HAGES E DATES 5 TETOR 1961)

1. Vendi: Republika e Italisë

Ky dokument publik

2. Eshtë nënshkruar nga RADICO M.

3. Duke ushtruar funksionin e NENPUNESIT

4. Mbajtes i vules së Vula e Shtetit Dhoma e tregtisë Industrisë artizanatit dhe agrikultures në Milano

Vertetohet

5. Në MILANO

6. Datë 6 nëntor 2012

7. Nga prefektura

8. nr. 19105

9. vula Vula e Shtetit

10. nënshkrimi

Përktheu
Aida Sino
P. Sino 204

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 14352 Rep.



Tirane, me 21.11.2012

VERTETIM PERKTHIMI

Vertetohet firma e perkthyeses se gjuhes Italiane Znj. Aida Sino, e njohur personalisht prej meje noterit, e cila deklaroi se perktheu dokumentin bashkangjitur, ne menyre autentike nga gjuha Italiane ne gjuhen Shqipe dhe nenshkroi rregullisht sipas ligjit.



NOTERI
JULIAN ZHELEGU